

Historiografia e shek. XIX mbi Napoleon Bonapartën dhe Kongresin e Vjenës

Regjimi diktatorial i Napoleonit e kishte ngulfatur fjalën e lirë, ashtu që burimet publicistike të kohës janë shumë të rralla. Vërshimi i furishëm i broshurave dhe pamfleteve nga koha e revolucionit u ndalua, madje edhe numri i gazetave shumë u zvogëlua, ndërkaq tirazhi i atyre që mbetën tej mase ra. Ato gazeta që dilnin ishin ose zyrtare ose të inspiruar nga pushteti ose nën censurë të ashpër. Në këtë mënyrë, publicistika franceze e kohës së Napoleonit mund të shfrytëzohet vetëm për t'i njohur tendencat dhe inspirimet e Qeverisë, e jo disponimin e opinionit publik. Për më tepër, ato publikime, janë të mangëta për nga informacionet edhe për ngjarjet e mëdha luftarake, për ngjarjet tjera publike si dhe për personalitetin e vet Napoleonit. Në Paris kishin mbetur vetëm nëntë gazeta, ndërkaq në departamente nga një, dhe atë duke qenë nën ndikim të prefektëve. MONITOUR nga viti 1799 u bë organ zyrtar i Qeverisë. Kjo gazete dhe procesverbalet e mbledhjeve të dy organeve përfaqësuese: Tribunatit dhe Trupit Ligjdhënës, përmbajnë material të konsiderueshëm të dokumentacionit zyrtar si dhe materiale të ngjashme. Pas rënies së Napoleonit filloi të mblidhej materiali publicistik, gazetat, broshurat, pamfletet, satirat, historitë sensacionale mbi aferat dhe dashuritë e fshehta të Napoleonit dhe të vëllezërve të tij. Edhe shkrimtarët e njohur të kohës, Shatobrien dhe Benzhamen Konstan, publikuan shkrime të tyre nëpërmjet të cilave sulmonin ashpër Napoleonin. Sulmohej sidomos politika e tij e brendshme despotike, dhe e jashtme pushtuese. U publikuan edhe përmbledhje serioze të dokumenteve të cilat u shfrytëzuan për qëllimin e njëjtë, që në mënyrë dokumentare të vërtetonin politikën e keqe të jashtme dhe të brendshme dhe jetën e korruptuar të bartësve të regjimit të Napoleonit.

Shtetet evropiane shpejt e harruan hakmarrjen, madje as diskreditimi i Napoleonit nuk ishte aq i nevojshëm për ta, sa ishte i nevojshëm për regjimin e Restaurimit. Kështu, jetën e Napoleonit, Gëte e konsideronte jetë të gjysmëzotit. Madje, te shkrimtarët u shfaq një ndjesi ngushëllimi ndaj tragjedisë që kishte pësuar ky personalitet. Gjermani Hajne në vitin 1816 shkroi “Dy grenadirët”, anglezi Bajron “Odë mbi Napoleon Bonapartën”, italiani Manconi “Pesë Maji”, me rastin e vdekjes së Napoleonit në vitin 1821. E lartësonin rusi Pushkin e pastaj edhe francezët: Viktor Hygo, Beranzhe, në vitet e tridhjeta Stendali, de Vinji, de Mise etj. Qysh në vitet e para të deportimit të Napoleonit në ishullin Shën Helena, u publikua në Londër broshura me titullin “Manuscrit venu de Sainte-Hélène” (1817). Ky ishte një mistifikim, sikur këtë broshurë e kishte hartuar Napoleoni, në të cilën ai mbron veten e tij dhe veprën e tij. Këtë broshurë e kishte lexuar pastaj edhe vet Napoleoni në ekzil dhe e kishte konsideruar vepër epokale, por duke shënuar edhe një numër të madh përmirësimesh. Këto përmirësime pastaj u shtypën në korrespondencën e tij të publikuar. Historianët më vonë u morën me supozimin se kush e kishte shkruar broshurën në fjalë. Në listën e të supozuarve ata futën shkrimtarin Benzhamen Konstan, Snijes, Madam Stal dhe sidomos zhenevasin Lilen de Shatovje. Napoleoni kishte deklaruar se e njëjta shkrimtarin, por që Shatovie kurrë nuk e kishte takuar personalisht Napoleonin. Megjithatë, edhe historiani i Napoleonit, Driol, dhe shumë historianë tjerë të mëvonshëm e konsiderojnë pikërisht de Shatovjenin autor të kësaj broshure, ndonëse sipas supozimit të Napoleonit ai e kishte shkruar nën inspirimin e madam Stal-it e cila nëpërmjet kësaj vepre dëshironte pajtimin me Napoleonin në mënyrë që t'i propagandonte idealet revolucionare kundër Restaurimit reaksionar, me çka do të fillonte aksionin liberal opozicionar. Njëri ndër

kritikët e mëvonshëm mendonte se autor i kësaj broshure ka qenë shkrimtari Marmon, i cili në atë dorëshkrim ia kishte veshur Napoleonit fjalët me të cilat ai ishte penduar që pas dorëzimit të Parisit më 1814 e kishte quajtur Marmonin tradhtar.

Biografia e parë e vërtetë e Napoleonit arriti nga Shën Helena menjëherë pas vdekjes së tij më 1821. Në anonimitet dhe me objektivitet të madh aty vlerësohet Napoleoni, pozitivisht për famën e tij ushtarake dhe administratën tepër mirë të rregulluar që nuk kishte shembull në histori, por negativisht, për sundimin e tij tiran duke e ngulfatur lirinë.

Përveç atyre biografive, po ashtu edhe gjatë jetës së Napoleonit edhe pas vdekjes së tij u publikuan përjetimet dhe kujtimet e personaliteteve të rrethit të tij në ekzil, duke e emocionuar opinionin e gjerë frëng mbi sjelljet agresive të mlekëmbësit Hadson Loves ndaj Napoleonit, pastaj mbi jetën e tij në ekzil dhe mbi idetë e tij. Kësisoj, u publikuan përjetimet e mjekëve të Napoleonit, dr. Vorden dhe irlandezit O'Meara, ndërkaq dr. Antonmarhi shkroi mbi orët e fundit të Napoleonit. Sukses të madh por edhe dobi materiale pati shoqëruesi i tij vullnetar në Shën Elenë, grofi Las Kazes, i cili botoi "Memorialin" e tij në 8 vëllime i cili u botua në frëngjisht dhe u përkthye në shumë gjuhë të botës. Po ashtu edhe shoqëruesi tjetër grofi Montolon i publikoi kujtimet e tij mbi ekzilin, ndërkaq së bashku me gjeneralin Gurgo, botoi "Memoaret mbi historinë e kohës së Napoleonit", të shkruara në ishullin e Shën Helenës në 8 vëllime. Kujtimet e tilla nga Shën Helena u pritën me entuziazëm dhe simpati nga publiku, ndërkaq nga publiku frëng i Francës së dobësuar u prit me krenari sepse ua kthente kujtimet nga koha e idealeve të lirisë revolucionare dhe fuqisë dhe famës perandorake. Njëra pjesë e shkrimtarëve nga Shën Helena e idealizonin Napoleonin (ai veten e vet, Las Kazes, Montolon, O'Meara), ndërkaq të tjerët e prezentonin besnikërisht në sinqeritetin dhe brutalitetin e tij (Gurgo, ledi Malkolm etj.).

Në frymën e fuqisë gjithnjë e në rritje të kultit të Napoleonit, edhe gjeneralët e tij shkruan kujtimet e tyre apo historitë e luftërave të Napoleonit. Një histori të tillë e publikoi gjenerali grof. Dima (Dumas) në 19 vëllime, ndërkaq gjenerali Bove (Beauvais) në 28 vëllime. Bove po ashtu botoi edhe korrespondencën zyrtare të Napoleonit në 7 vëllime, ndërkaq kapiteni Guzhon, i publikoi raportet zyrtare të armatës së madhe, ndërkaq grofi Filip de Segir "Historinë e Napoleonit dhe ushtrisë së madhe të v.1812" (2 vëllime, 1824). Material i bollshëm memoaristik për periudhën e Napoleonit u botua aso kohe në koleksionin e madh *Mémoires relatifs à la Révolution française* par Berville et Barrière, 60 vol. 1820-1828.

Njëkohësisht filluan të publikohen edhe biografitë e Napoleonit, sikurse ajo nga gjenerali grofi Zhormini (4 vell., 1827). Edhe vepra e historianit Tjeri "Historia e Revolucionit Francez" përshkroi fitoret e para të shkëlqyera të Bonapartës. Romansieri i madh skocez Volter Skot e shkroi një biografi të madhe të Napoleonit, duke i nënvizuar sukseset e Napoleonit në realizimin e shpejt të tentativës shekullore të Francës për supremaci në Evropë, duke i unifikuar francezët dhe duke i bërë popull-mbret të Evropës. Sipas Skotit, Napoleonit i pëlqeu kjo famë prandaj edhe ia flijoj egoizmit të tij idealet më të dashura frënge. Kundër librit të Skotit u publikuan në Francë me dhjetëra polemika.

Nipi i Napoleonit, Lui Napoleon Bonaparte, në vitin 1836 tentoi ta ngritë në kryengritje garnizonin e Strasburgut, mirëpo u zu dhe u deportua në Amerikë. Tre vjet më vonë ai e publikoi broshurën "Idetë e Napoleonit" në të cilën i madhëron idetë revolucionare dhe sociale të xhaxhait të vet. Kjo vepër së shpejti përjetoi 5 ribotime.

Interesimi i publikut për traditën napoleoniane ishte aq i madh në Francën e gjysmës së parë të shek. XIX sa që kishte edhe të tillë nga mesi i historiografëve francezë që shkruanin edhe memoare të trilluara, duke e mistifikuar Napoleonin dhe përhapur legjenda se një ditë perandori i madh do të ngrihej nga varri.

Regjimi i korrikut nuk u frikësua që ta sillte në v. 1840 trupin e Napoleonit nga Sën Helena në Paris. Amerikani Emerson e radhiste Napoleonin në mesin e “përfaqësuesve të racës njerëzore” (1850). Atëbotë, historiografi i njohur frëng Tjer kishte filluar me publikimin e veprës madhore “Historia e Konsultës dhe e Perandorisë” në 20 vëllime (1845-1862). Kjo vepër sipas autorit, u shkrua duke u mbështetur në materiale të shumta të arkivave parisiane, ku kishte lexuar 30 mijë letra personale të Napoleonit. Në këtë edicion spikatën sidomos çështjet ushtarake, financiare dhe diplomatike. Vepra është e rëndësishme si një vepër e madhe, me materiale të shpëtuara, ndonëse ka edhe zbrazësi dhe gabime të caktuara.

Koha e Perandorisë së Dytë

Kur Napoleoni III bëri grusht-shtet dhe themeloi Perandorinë e Dytë, filluan shkrimtarët demokratë, për shkak të urrejtjes ndaj tij, të shkruajnë sa më negativisht kundër Napoleonit I. Në mesin e tyre u dallua historiani Lanfrej, me veprën e tij të papërfunduar “Historia e Napoleonit I” në 5 vëllime (1867-1875). Napoleoni III iu përgjigj me ndalimin e këtyre librave dhe me ngritjen e kultit të Napoleonit I, e sidomos me publikimin e madh të korrespondencës së tij në 32 vëllime, 1858-1870. Aso kohe u publikuan edhe memoaret e vëllezërve të Napoleonit. Dritë të re në prezentimin e personalitetit dhe politikës së Napoleonit hodhi publikimi i memoareve dhe akteve të arkivit personal (1869-1873), të kundërshtarit të madh të Napoleonit, kancelarit austriak Meternik, i cili ia pranonte virtytet e udhëheqësit ushtarak, ligjdhënësit dhe administruesit, por që e gjykonte imperializmin e tepruar i cili mbështetej mbi themele të pasigurta.

Koha e Republikës së Tretë

Me rënien e Napoleonit III u rritën tendencat antinapoleoniane. Pasqyrim shumë të keq të personalitetit dhe politikës së Napoleonit u dha në memoaret e gruas së prefektit të Napoleonit, Madam de Rémusat (3 vëll. 1879-1880). Ajo, sikurse edhe shumë adhurues tjerë të shumtë të Napoleonit, me kohë u këndell nga entuziazmi dhe filloi të ndjejë gjithë tiraninë me të cilën perandori e kishte ndrydhur shoqërinë dhe popullin. Thyerja e Napoleonit III i kushtoi keq edhe vlerësimeve pozitive që ishin dhënë deri atëherë për Napoleonin I. Historianët e asaj kohe nuk nguruan të shkruanin në mënyrë mohuese ndaj virtyteve ushtarake të Napoleonit dhe sidomos duke ua mohuar bazën etike. E akuzonin për mungesë të idealeve dhe për egocentrizëm. Në këtë aspekt më i ashpri ishte Ten (1887) i cili, në frymën e teorisë së tij raciste, Napoleonin e konsideronte si një kondotier italian, duke e gjykuar për centralizmin e tij të ashpër. Fushata antinapoleoniane shkoi deri aty sa që e mallkuan edhe emrin Bonaparte. Mirëpo, përkundër kësaj fushate, kulti i Napoleonit megjithatë nuk u shua. Gambeta shkruante me admirim mbi aftësitë oratorike dhe strategjike të Napoleonit si dhe mbi fuqinë e Perandorisë së Parë, duke shikuar në te me admirim, mallëngjim dhe shpresë nga prizmi i kohëve të vështira nëpër të cilat po kalonte Franca pas thyerjes në vitet 1870-1871. Atëbotë u publikua edhe glorifikimi postmortal i Stendalit për Napoleonin I (1876). Pastaj doli Niçe me kualifikimin e Napoleonit si bashkues të fuqishëm të Evropës, pak më vonë doli monografia e anglezit Sili (Seeley) 1886 i cili politikën e jashtme të Napoleonit e kishte shpjeguar si tentativë për nënshtrimin e Evropës për ta luftuar kështu Anglinë. Aso kohe doli nga shtypi një vepër mbi Napoleonin, e shkruar në frymë objektive shkencore, pa paragjykime politike, nga profesori i Universitetit të Vjenës, August Furnier (August Fournier), “Napoleon I eine Biographie”, 3 Bde. 1886-1889. Qëndrim të matur kishte edhe qeveria republikane e Francës së asaj kohe duke e organizuar ekspozitën e relikeve të

Napoleonit në Shtëpinë e Invalidëve në vitin 1889. Publiku frëng ishte shumë i interesuar për traditën napoleoniane mbi artefaktet, artin dhe letërsinë. Pra, doli tendenca që Napoleoni as mos të glorifikohej, as mos të demonizohej, por të prezentohej si një borgjez i mirë bashkë me virtytet dhe dobësitë borgjeze. Në këtë frymë, Levi e paraqiti personalitetin e Napoleonit (Arthur Lévy, *Napoléon intime*, 1893), ndërkaq prezentimin e mbarë familjes Bonaparte, e dha historiani më i madh i saj Frederik Mason (13 vëll. 1897-1919). Historiani i revolucionit i pranon meritat e politikës së Napoleonit për pajtimin kombëtar dhe liberalizmin. Ndërkaq, Sorel duke folur për politikën e tij të jashtme, shihte aty vetëm mbrojtjen e kufijve natyror të Francës dhe sigurimin e tyre nga sulmet e ardhshme.

Në historiografinë frënge të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek.XX, Eduard Driol (Edouard Driault) konsiderohet si specialisti më i madh për politikën e jashtme të Napoleonit (*La Politique orientale de Napoléon, Sébastiani et Gardane*, 1806-1808, 1904; *Napoléon en Italie* 1906; *Napoleon et l'Europe*, 5 vol. 1910-1927. Driol ia përshkruan Napoleonit planin e madh për krijimin e Evropës së unifikuar. Driol e themeloi edhe revistën *Revue des Études des napoléoniennes*, 1912.

Me shkatërrimin e dinastisë habsburge pas Luftës së Parë Botërore, u hapën mundësi që më lirshëm të hulumtohet dhe publikohet materiali nga arkivat e Vjenës. Nga arkivi familjar i Habsburgëve, Qeveria franceze bleu në licitacion të v. 1934 letrat origjinale të Napoleonit dërguar Maria Luizës.

Albert Menie (Albert Meynier, *Pour et contre Napoléon, Le procès historique de l'empereur. Revue des Études, juillet-aout 1933*) bëri një punë interesante. Ai përpiloi një proces gjyqësor historik mbi Napoleonin duke i vënë në pah të gjitha akuzat të ngritura kundër tij dhe argumentet e mbrojtjes, duke e përcaktuar madje edhe raportin e luftës botërore sipas veprës së tij, ashtu që më në fund, në konkluzion e shpreh vendimin gjyqësor i cili përmbledhet në fjalët: AI, ËSHTË NE. Në këtë mënyrë Manie e ka paraqitur Napoleonin si përfaqësues të virtyteve dhe ligësive të popullit francez – gjë të cilën e kishin nënvizuar edhe shumë historianë para tij.

Historiografia mbi Kongresin e Vjenës

Historiografia e shek. XIX mbi Kongresin e Vjenës është shumë e pasur. Këtu para së gjithash duhet nënvizuar se historiografia e këtij shekulli kishte në dispozicion materiale të vlefshme burimore. Posaçërisht i rëndësishëm ishte “Ditari” i sekretarit të Kongresit, Fridrih fon Genc, në 4 vëllime, pastaj “Letrat” që i kishte shkruar dhe pranuar, pastaj “Memoar zotëruesit të Vllahisë Karaxha”, të cilit për honorar të mirë dhe sipas direktivës së Meternikut, ia kishte dërguar raportet mbi situatën diplomatike ndërmjet viteve 1812-1818. Genc i shpjegon të gjitha ngjarjet në Kongres, duke e nënvizuar urrejtjen ndërmjet Meternikut dhe carit rus Aleksander, por duke e hedhë gjithë fajin mbi Aleksandrin. (Monografia mbi Gencin në gjuhën frënge A. Robinet de Clery, 1917). I biri i Meternikut, Rikardi, i botoi memoaret dhe korrespondencën e të atit. Po ashtu deri në Luftën e Parë Botërore u publikuan edhe korrespondencat e diplomatëve britanikë dhe rusë, pastaj korrespondencat ndërmjet ambasadorëve rusë dhe frëng në periudhën

1814-1830. Një serë publikimesh u nxorën edhe lidhur me politikën e fshehtë në Kongresin e Vjenës, pastaj mbi zbavitjet në Kongres etj.

Disa tutuj të sugjeruar nga Intereneti:

1. Fleury de Chaboulon, Pierre Alexandre Édouard, baron, 1779-1835 -Memoirs of the Private Life, Return, and Reign of Napoleon in 1815, Vol. I
2. Fleury de Chaboulon, Pierre Alexandre Édouard, baron, 1779-1835 -Memoirs of the Private Life, Return, and Reign of Napoleon in 1815, Vol. II
3. Foa, Eugenie -The Boy Life of Napoleon Afterwards Emperor of the French
4. Henty, G. A. (George Alfred), 1832-1902 -At Aboukir and Acre A Story of Napoleon's Invasion of Egypt English
5. Hugo, Victor, 1802-1885 -Napoleon the Little English
6. L. Mühlbach Napoleon and the Queen of Prussia English
7. Amphiteatrof, Alexander Balzac, Honoré de, 1799-1850 Kennan, George, 1845-1924
8. The Napoleon of the People; L. Mühlbach
9. Lockhart, J. G. (John Gibson), 1794-1854 The History of Napoleon Buonaparte
10. Lord, John, 1810-1894 A Modern History, From the Time of Luther to the Fall of Napoleon For the Use of Schools and Colleges English
11. Mühlbach, L. (Luise), 1814-1873 Napoleon and Blucher
12. Mühlbach, L. (Luise), 1814-1873 Queen Hortense A Life Picture of the Napoleonic Era
13. Rose, Achilles Napoleon's Campaign in Russia Anno 1812
14. Rose, John Holland, 1855-1942 The Life of Napoleon I (Complete)
15. Rose, John Holland, 1855-1942 The Life of Napoleon I (Volume 1 of 2)
16. Rose, John Holland, 1855-1942 The Life of Napoleon I (Volume 2 of 2)
17. Runciman, Walter, 1847-1937 Drake, Nelson and Napoleon
18. Segur, Philippe-Paul, comte de, 1780-1873 History of the Expedition to Russia Undertaken by the Emperor Napoleon in the Year 1812
19. Sloane, William Milligan, 1850-1928 The Life of Napoleon Bonaparte Vol. I. (of IV.)
20. Thackeray, William Makepeace, 1811-1863 The Second Funeral of Napoleon
21. Recollections of the Private Life of Napoleon — Complete
22. Whately, Richard, 1787-1863 Historic Doubts Relative To Napoleon Buonaparte
23. Wilde, Oscar, 1854-1900 Charmides and Other Poems
24. Abbott, John S. C. (John Stevens Cabot), 1805-1877 Napoleon Bonaparte
25. Amphiteatrof, Alexander Balzac, Honoré de, 1799-1850 Folk-Tales of Napoleon The Napoleon of the People;
26. Balzac, Honoré de, 1799-1850 The Napoleon of the People
27. Bourrienne, Louis Antoine Fauvelet de, 1769-1834 Memoirs of Napoleon — Complete